



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E PEJËS

DEGA NË KLINË

P.nr.103/20020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të pandehurit: I. (S.) K. ngaK. për shkak të veprave penale: „Kanosje“ nga neni 338 par 1 të KPRK-së, i akuzuari sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/Il.nr.982/2020, të dt. 31.08.2020, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të Shtetit Ersan Qavolli nga Prokuroria Themelore në Pejë, dhe të pandehurit të lartcekur, mbajtjes së seancës pas mbajtës së seancës fillestar më dt:23.12.2020, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, kurse me datën: 28.12.2020 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: I. K. nga babai S., dhe i nënës S. gjinisë Sh., i lindur me dt:, me vendbanim në fsh.K., ka të kryer shkollën fillore, i martuar , i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, pensionist, identifikohet me nr. personal: shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Per shkak se:

Me datë 04.10.2020, rreth orës 13:00, në magjistralen, teknë, seriozisht kanos të dëmtuarin Sh. A., në atë mënyrë që, ditën kritike, përderisa i dëmtuari ishte me familje duke u kthyer nga Prishtina, i njëjti pranon një thirrje telefonike nga numri, pronë e të pandehurit, ku ky i fundit iu ka drejtuar me fjalët fyese dhe kanosëse: „Kam me ta q...nënën, babën, kam me vra veç mos u takofshim, kam me ti hjek kamt, kam me ta ba bajat jetën“, me ç’rast i dëmtuari duke e djerë veten të kanosur e lajmëron rastin në polici.

-me çka ka kryer veprën penale, “Kanosje”, nga neni 181 par.2 e lidhur me par. 1 të KPRK-së. Prokurori i shtetit ka bërë përmirësimin e aktakuzës i cili duhet të jetë:

-me çka ka kryer veprën penale, “Kanosje”, nga neni 181 par.2 e lidhur me par. 1 të KPRK-së.

G J Y K O N

DËNIM ME KUSHT

I. Të akuzuarin: I. K. e dënon me dënim me gjobë shuma në vlerë prej 350 (treqind e pesëdhjetë) Euro, i cili dënim, nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale.

II. Detyrohet: i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 20 (njëzet) Euro, si dhe shpenzimet për kompensim të viktimave të krimit shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. UDHËZOHET: Pala e dëmtuar: Sh. A. nga fsh.K., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzë, PP.II.nr.982/2020 të dt: 31.08.2020, ka akuzuar, I. K., për shkak të veprës penale: „Kanosje” nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datën 18.11.2020 ne praninë e Prokurorit të Shtetit Ersan Qavolli, dhe të pandehurit I. K., ndërsa duke vepruar konform nenit 245 par 1 të KPPRK-së, nuk i ka ftuar palët tjera në seancën fillestare.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit i pandehuri deklaroj, se e pranoj fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohem, me vjen keq për rastin qe me ka ndodhur, duke deklaruar se ketë e kam bërë nga pakujdesia, është hera e parë qe kam renë ndesh me ligjin,, premtoj se nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjajshme penale, dhe i njëjti . kërkon flje publike në gjykatë

Prokurori i shtetit pas leximit të aktakuzës, fillimisht bëri përmirësimin e kualifikimit juridik të veprës penale e cila duhet të jetë : Vepra penale,„Kanosje” nga neni 181 par. 2 të KPRK-së, pra nuk duhet të jetë paragrafi 1.

Prokurori i shtetit deklaroj, se pajtohet me pranimin e fajësisë, i cili pranim ka mbështetje ne provat qe gjenden ne shkresat e lendes, dhe është bere komfor dispozitave ligjore, propozoj gjykatës qe me rastin e marrjes se vendimit mbi dënim pranimin e fajësisë, te marr si rrethanë lehtësuese.

Pas deklarimit te pandehurit se e pranon fajësinë, mendimit të prokurorit se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Gjykata konstatoj se i pandehuri pranon fajësinë ne mënyre vullnetare, pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimit te fajësisë, si dhe te gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 te KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata me aktvendim në procesverbal aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si

dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 248 par.1 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit konform nenit 248 par 4 te KPPRK-se.

Andaj nga pranimi i fajësisë dhe provat materiale nga shkresat e lëndës është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ku është vërtetuar se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale ” Kanosje” nga neni 181 par. 2 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që i pandehuri ka qenë i pakujdesshëm për veprën penale te kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës, për veprën penale me të cilën është akuzuar.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim te nenit 69 dhe 70 te KPRK-se.

Kështu si rrethana lehtësuese për te pandehurin gjykata gjeti se i pandehuri ka treguar sjellje korrekte gjate shqyrtimit fillestar e për me tepër ka pranuar fajësinë dhe ka shpreh keqardhje për veprën qe e ka kryer, është në moshë të shtyre-penzioner dhe të ardhurat i siguron nga pensioni i pleqërisë, si dhe është hera e parë qe bije ndesh me ligjin.

Rrethanë rënduese Gjykata gjeti shkallen e rrezikshmërisë që paraqet kjo vepër penale dhe dënueshmërin e saj, ku për këtë vepër penale parashihet dënim me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pajtim me nenin 38 të KPRK-së, si dhe në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësorë si në dispozitiv të aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par. 3 nënpar. 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për mundësin e pagesës se dënimit më këste është marrë konform nenit 43 par.2 të KPK-së, duke marrë për bazë faktin se i pandehuri është i pensionuar.

Vendimi për konfiskim të armës dhe municionit është marrë konform nenit 366 par.3 të KPRK.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA KLINË
P.nr.103/2020 më dt: 29.12.2020

Procesmbajtësja:
Shere Desku

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet
Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e
pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në